



E-transparenca

ÇFARË DUAN TË DINË
QYTETARËT NGA
PUSHTETI LOKAL?



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian
dhe i ko-financuar nga Ambasada Britanike



ALKA





E-TRANSPARENCA: ÇFARË DUAN TË DINË QYTETARËT NGA PUSHTETI LOKAL?

**PROJEKTI
“QYTETARËT NË REND TË PARË”**

korrik, 2016



E-TRANSPARENCA: ÇFARË DUAN TË DINË QYTETARËT NGA PUSHTETI LOKAL?

Botues: Qendra për Administrim me Ndryshime Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm ALKA

Për botuesin:

Neda Maleska Saçmaroska, Qendra për Administrim me Ndryshime
Elizabeta Gjorgjievska, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm ALKA

Autorë:

Neda Maleska Saçmaroska, Memet Memeti, Martin Todevski, Daniela Andreska

Bashkëpunorë:

Ministria e ushtetit Lokal, Eli Çakar, Këshilltar shtetëror
Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Gordana Gapiç Dimitrovska, shef i njësisë

Redaktorë: Martin Todevski

Lektura: AD VERBUM Shkup

Превод: AD VERBUM Shkup

Disenji dhe shtypi: Brigada dizajn

Тираж: 240 ekzemplarë (Tirazh falas/jokomercial)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

352:004.738.5(497.7)

E - transparenca : çfarë duan të dinë qytetarët nga pushteti lokal?. - Shkup : Qendra për administrim me ndryshime, 2016. - 53 стр. : граф. прикази ; 24 см Публикацијата е во рамките на проектот: “Граѓанинот на прво место”. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 51-53

ISBN 978-608-4818-00-7

a) Локална самоуправа - Веб страници - Пристап до информации - Македонија

COBISS.MK-ID 101827850

Projektet “Qytetari në rend të parë” implementohet nga Qendra për Administrim me Ndryshime dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm ALKA, financuar nga Unioni Evropian dhe i kofinancuar nga Ambasada Britanike në Shkup.



Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton opinionin e Unionit Evropian.



Ky publikim është i kofinancuar nga Ambasada Britanike. Opinionet dhe pikëpamjet e këtij publikimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet apo qëndrimet e Ambasadës Britanike në Shkup.



PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. RËNDËSIA SHOQËRORE E TEMËS	7
2.1. TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA, PJESËMARRJA - RAPORTI MIDIS PUSHTETIT DHE QYTETARËVE	7
2.2. QEVERI E HAPUR DHE TË DHËNA TË HAPURA - KONCEPTET DHE TË KUPTUARIT	8
2.2.1. Partneritet i hapur qeveritar	8
2.2.2. Të dhëna të hapura	9
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	14
4. ANALIZA E REZULTATEVE TË KËRKIMIT	18
4.1. MJEDISI I MUNDËSISË - ANALIZA E KORNIZËS AKTUALE LIGJORE, DOKUMENTEVE, PRAKTIKAT / PROTOKOLLEVE PËR TRANSPARENÇË	18
4.2. ANALIZA E PUBLIKUT PËR PUNËN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE, PËRMES UEB FAQES SË NJVL	27
4.3. ÇFARË MENDOJNË QYTETARËT	35
4.1.1. Vërejtje të përgjithshme	35
4.1.2. Financa	37
4.1.3. Këshilli	38
4.1.4. Shërbime	39
4.1.5. Zhvillimi ekonomik lokal	40
4.1.6. Mjedisi jetësor	41
4.1.7. Shërbime komunale	42
4.1.8. Kulturë	43
4.1.9. Arsimit	43
4.1.10. Mbrojtje sociale	44
4.1.11. Sport	44
4.1.12. Urbanizëm	44
4.1.13. Kopshte fëmijësh dhe shtëpi pleqsh	46
5. REKOMANDIME	47
6. LITERATURA E PËRDORUR	49





1. HYRJE

Pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e politikës lokale dhe mundësia të ndikojnë në formimin dhe përmirësimin e vendimeve që kanë drejtpërdrejt ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin lokal, janë parakushte thelbësore për qeverisjen demokratike në nivel lokal. Që të mund të marrin pjesë me iniciativat dhe propozimet e veta qytetarët duhet lirshëm të hyjnë në të dhënat dhe informatat dhe ti ndajnë me qytetarët tjerë.

Roli i qeverisjeve dhe administratës lokale në procesin e ndërtimit të një dialogu të hapur dhe i dialogut pjesëmarrës politik, përfshin gjetjen e qasjeve të reja që do ta forcojnë përfshirjen e të gjitha palëve relevante në marrjen e vendimeve, që nga ana tjetër, nënkupton politika më të mira, vendime të komunikuar mirë dhe mbështetje nga komuniteti në zbatimin e tyre.

Duke përkthyer këtë kuptim kolokvial të proceseve demokratike në krijimin e politikës lokale, në realitetin konkret të shoqërisë së Maqedonisë, imponohen dy çështje thelbësore: (1) sa pushteti lokal dhe administrata nëpërmjet të dhënave dhe informatave që i posedon është e hapur për ndikimin e interesave të shoqërisë, (2) cilat të dhëna dhe informacione janë të nevojshme për qytetarët, që ta ushtrojnë atë ndikim, duke ndjekur atë që prodhon politika (policy), apo nëse politikat lokale e përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe në çfarë mase?

Natyrisht, sot, përpjekjet për modernizimin e menaxhimit në nivel lokal dhe përmes përfshirjes së qytetarëve në ndërtimin e politikave dhe shërbimeve më efektive duhet ti marrë parasysh mënyrat inovative të komunikimit që i imponon zhvillimi i teknologjive TKI, në krahasim me mekanizmat tradicionale të konsultimit dhe komunikimit me qytetarët.

Kështu, në një epokë në të cilën inovacionet dhe zhvillimi teknologjik merr hov gjithnjë e më të madh, hulumtimet në kuadër të projektit “Qytetari në rend të parë”, titulli i cilit simbolikisht tregon objektivat strategjike të projektit ka për qëllim të hapë një debat thelbësor mbi nevojën për afirmimin e e-qeverisjes dhe zbatimit të standardeve të vetme për pu shtet të hapur lokal dhe të dhëna të hapura, si hap drejt përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve dhe inkurajimin e iniciativave të qytetarëve dhe organizatave civile nëpërmjet teknologjive moderne që të japin kontributin e tyre në jetën publike dhe në jetën e komunitetit.

Hulumtimi përbëhet nga katër elemente përbërëse: (1) analiza e kuadrit ligjor që rregullon mjedisin nga aspekti normativ në drejtim të promovimit dhe ushtrimit e transparencës dhe llogaridhënies, duke përfshirë detyrimet ndaj vetëqeverisjeve lokale për të mbajtur shënime të ndryshme apo regjistra dhe baza të të dhënave;

¹ Ky projekt është realizuar nga “Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve” në partneritet me “Qendrën për zhvillim të qëndrueshëm ALKA”. Bashkëpunëtorë në këtë projekt janë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Projekti është i financuar nga Delegacioni Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhjen e kontraktiveve (CFCD) dhe i bashkë-financuar nga Ambasada Britanike.



(2) analiza e zbatimit të dispozitave ligjore në nivel lokal duke analizuar statutet e tetë njësive urbane të vetëqeverisjes lokale dhe ueb faqet e tyre; (3) Shqyrtim i mendimit, nevojave dhe interesave të qytetarëve në drejtim të transparencës dhe qasjes në të dhëna dhe informacione nën juridiksionin e vetëqeverisjeve lokale dhe IT gatishmëria e komunave për të publikuar të dhëna të hapura, dhe; (4) Analizë krahasuese e praktikave më të mira për të dhëna të hapura në Bashkimin Evropian.

Hulumtimi ka për qëllim të iniciojë debat të mëtejshëm mbi këtë temë dhe të kontribuojë në përmirësimin e përfshirjes së shoqërisë civile në krijimin e opinionit publik, politikave lokale dhe vendimmarrjes përmes promovimit të *standardeve të përpushtet të hapur dhe të dhëna të hapura*.



2 RËNDËSIA SHOQËRORE E TEMËS

2.1 TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA, PJESËMARRJA - RAPORTI MIDIS QEVERISË DHE QYTETARËVE

Dëbatet mbi reformën e administratës publike, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne, janë gjithnjë më me ndikim në drejtim të implementimit më efektiv të politikave kombëtare dhe lokale, jo vetëm në Maqedoni, por edhe përtej.

Qytetarët individualisht ose së bashku në grupe të organizuara, duke përfshirë edhe sektorin privat, kanë shpresa gjithnjë e më të mëdha nga autoritetet kombëtare dhe lokale për të ofruar më shumë shërbime më të mira dhe më të ndryshme me më pak resurse.

Në anën tjetër, pritjet nga çdo pushtet janë që të punojnë në interes të qytetarëve dhe për të gjithë qytetarët. Prandaj, për të justifikuar qëllimin e veprimit të tyre, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, autoritetet lokale janë të detyruara të pranojnë se qytetarët me njohuritë e tyre, shkathtësitë dhe entuziazmin mund të luajnë një rol kyç në këtë proces.

Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja në një demokraci moderne duhet të lejojë impulset e jashtme dhe idetë të merren parasysh gjatë trajtimit të problemeve komplekse në shoqëri. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e bën sistemi politik në vend më demokratik dhe më përfshirës. Kjo qasje inkurajon iniciativën e qytetarëve që të mobilizohen dhe të angazhohen në procesin politik dhe ta rikthejnë besimin në institucionet. Për administratën kjo do të thotë më shumë mundësi për të mësuar institucionalisht, që mund të sjellë ndryshime të rëndësishme.

Në të njëjtën kohë, teknologjitë e reja dhe përdorimi i internetit si një mjet për informimin e qytetarëve, janë duke u bërë temë më e shpeshtë në diskutimet mbi reformën e administratës publike. E-menaxhimi ofron mundësi për një pushtet shumë më të përgjegjshëm dhe i kapërcen barrierat burokratike në qasjen ndaj informacionit dhe të dhënave. Kjo tregon se nuk mjafton më që autoritetet dhe institucionet ti përdorin metodat e vjetra të komunikimit. Ata kanë një detyrim të kërkojnë qasje inovative, dhe të dhënat duhet patjetër ti publikojnë në mënyrë të kuptueshme dhe të kapshme për qytetarët.

Nga ana tjetër qytetarët, në mënyrë individuale ose të organizuar në organizata qytetare, roli kryesor i të cilit është për të përfaqësuar interesat e grupeve të caktuara shoqërore, duhet të jenë të informuar në lidhje me mundësitë që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare për qasjen e të dhënave dhe informatave që të mund të kërkojnë përgjegjësi më të madhe dhe qasje. Vetëm qytetarë të informuar dhe të vetëdijshëm mund të ushtrojnë ndikim në proceset e hartimit të politikave dhe shërbimeve, dhe në këtë mënyrë të jetë gjithashtu një korigjues i pushtetit.



Nga kjo, iniciativa për hapjen e të dhënave nëpërmjet TKI e përmirëson jo vetëm transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve, por është potencial për transformimin e raporteve ekzistuese ndërmjet pushtetit dhe qytetarëve. Për qytetarët, kjo do të thotë më shumë kontroll mbi shpenzimin e fondeve publike dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje; për autoritetet përmirësim i efektivitetit të menaxhimit dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit; për shoqërinë kjo do të thotë mundësi për të shfrytëzuar të gjithë potencialin në rritjen e mëtejshme ekonomike dhe zhvillimin e vendit.

Duke ndjekur përvojën ndërkombëtare, ku qytetarët gjendjen në zemër të institucioneve demokratike dhe proceseve, projekti “Qytetari në rend të parë” ka për qëllim distribuimin e fuqisë politike të qytetarit përmes sigurimit të qasjes së plotë në të dhënat publike dhe informacione për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit lokal nëpërmjet aplikimit të teknologjive moderne.

2.2 QEVERI E HAPUR DHE TË DHËNA TË HAPURA - KONCEPTET DHE TË KUPTUARIT

Informacionet mbi të gjitha aktivitetet e pushtetit lokal dhe administratës lokale dhe të dhënat që i prodhojnë apo i kanë, duhet të jenë të kapshme për qytetarët, si dhe mundësia që t'i përdorin ato.

2.2.1 PARTNERITET I HAPUR QEVERITAR

Zhvillimi i teknologjisë në masë e ndryshoi natyrën dhe mënyrën se si njerëzit e kryejnë punën dhe ka bërë ndryshime të mëdha në qasjen tek informatat për njerëzit e moshave të ndryshme.

Si pasojë e gjendjeve të tilla në dekadën e fundit u shfaqën iniciativa të reja të tilla si **Partneriteti i hapur qeverisës (PHQ)** dhe koncepte të reja të tilla si **Qeveri e hapur dhe të dhëna të hapura**, funksioni i të cilit është përforcimi i procesit të menaxhimit (governance) duke përdorur teknologji të reja, si dhe ndryshimi i kulturës së punës në institucionet.

Edhe pse debatet për “qeveri të hapur” shfaqen diku në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar si një term që duhet të simbolizojë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e politikave, si dhe mundësinë e qasjes së lirë në informatat me karakter publik, por konceptet e qeverisë së hapur dhe të dhënave të hapura, ngritjen e tyre e përjetuan në dhjetë vitet e fundit, me zhvillimin e komunikimeve elektronike.



Domethënë, në shtator të vitit 2011 vendet më të zhvilluara² në botë, u angazhuan për promovimin e koncepteve të Partneritetit të hapur qeveritar dhe të dhëna të hapura nëpërmjet teknologjive të reja dhe të “sigurojnë informacion me rëndësi të madhe, duke përfshirë të dhëna të papërpunuara në kohë dhe në një format, që mund të jetë lehtësisht i arritshëm, i kuptueshëm, i qartë “ dhe në këtë mënyrë të promovojnë llogaridhënien politike.³

Sot, PHQ është rritur në një lëvizje së cilës iu bashkuan më shumë se 70 vende të botës. Shtetet nënshkruese të iniciativës për Partneritet të hapur qeveritar, u angazhuan në disa pika kryesore si kritere themelore në promovimin hapjes së institucioneve: transparenca fiskale e cila nënkupton publikimin me kohë të të gjitha dokumenteve të rëndësishme që lidhen me buxhetin dhe implikimet financiare, duke rritur llogaridhënien ndaj qytetarëve për atë se si institucionet e përdorin pasurinë e tyre; e drejta e qytetarëve për të pasur qasje në të dhënat që i krijojnë dhe me të cilat disponon sektori publik; dhe pjesëmarrja e qytetarëve në mënyrë individuale ose të organizuar, organizatave civile dhe komunitetit të biznesit në hartimin e politikave dhe menaxhim.

Në qershor të vitit 2012 Republika e Maqedonisë iu bashkua iniciativës “Partneritet i hapur qeveritar”, i cili synon të krijojë institucione transparente, të përgjegjshme dhe efektive në bashkëpunim të hapur me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Zbatimi i kësaj nisme në nivel lokal do të thotë autoritete të hapura lokale në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit, komunikim më i ngushtë dhe bashkëpunim i administratave komunale me qytetarët dhe organizatat civile, si dhe punë më transparente dhe më llogaridhënëse.

2.2.2. TË DHËNA TË HAPURA

Një nga shtyllat e iniciativës për PHQ është “të dhëna të hapura”, apo publikimi i të dhënave që sektori publik i ka në format përpunues kompjuterik për përdorim të lirë, për t’u përdorur dhe të rishpërndahen nga kushdo pa kufizime.

Në një kuptim filozofik, të dhëna të hapura do të thotë përfshirje më të mirë dhe pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të cilët që mund të përfitojnë nga të dhënat për t’i përdorur dhe t’i ndajnë, pa pengesa ligjore dhe e rëndësishmja, me entuziazëm për inovacion⁴.

Institucionet e sektorit publik, në kuadër të kompetencave të tyre mbledhin një numër të madh të të dhënave dhe informacioneve. Duke pasur parasysh faktin se puna e institucioneve financohet nga qytetarët, të gjitha të dhënat (që nuk janë të dhëna personale ose informacion i klasifikuar), u përkasin qytetarëve dhe duhet të publikohen, ose të “hapen” në formatin e të dhënave të hapura.

²G8—Franca, SHBA, Britania e Madhe, Rusia, Gjermania, Japonia, Italia dhe Kanadaja.

³OpenGovernmentDeclaration

⁴THE POWER OF OPEN, <http://thepowerofopen.org>



Aplikimi “Ku shkojnë paratë e mia”⁵ duke përdorur të dhëna të hapura, tregon se si ndahet buxheti në Britaninë e Madhe, duke përfshirë vizualizime, si ndahen tatimet e të ardhurave personale në një vlerë të caktuar, shpenzimet sipas rajoneve të vendit dhe shpenzimet sipas sektorëve.

Ueb portali www.offenerhaushalt.at i prezanton financat e komunave në Austri. Portali është zhvilluar nga Qendra për hulumtim në administratën publike KDZ Austri, në bazë të të dhënave të marra nga komuna për buxhetin e planifikuar dhe të realizuar sipas paragrafëve. Pavarësisht nga grupet në dispozicion të të dhënave, në portal krijohen vizualizime të ndryshme për komunën e zgjedhur, duke përfshirë vizualizim si është planifikuar buxheti, në cilat fusha shpenzohet buxheti komunal.

Përveç kësaj, vlera e përdorimit të të dhënave të hapura në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies, të dhënat e publikuara kanë edhe **potencialin e tyre ekonomik**. Rezultatet e disa studimeve tregojnë se vlera ekonomike e të dhënave të hapura është disa dhjetëra miliard euro në vit në Bashkimin Evropian. Me të dhënat që përdoren lirshëm dhe ri-përdoren, qytetarët e interesuar, kompanitë dhe organizatat zhvillojnë produkte dhe shërbime të reja përmes së cilëve realizojnë fitim⁶.

Aplikacioni mobil BlindSquare⁷, i cili ju ndihmon personave të verbër të lëvizin nëpër qytet. Aplikacioni është i bazuar në të dhëna të hapura për transportin publik dhe ato janë të kombinuara me të dhënat e vendndodhjes nga rrjeti social Foursquare, si dhe mjetet për harta GPS, dhe të folur artificial i celularëve të mençur. Produkti tani operon në shumë vende dhe në më shumë gjuhë, dhe shitet për rreth 17 euro.

⁵ Where does my money go—<http://app.wheredoesmymoneygo.org/>

⁶ Qendra për menaxhim me ndryshimet (2012), „Analiza krahasuese e praktikave më të mira për të dhëna të hapura në Bashkimin Evropian”

⁷ <http://blindsquare.com/>



Megjithatë, është e rëndësishme të dihet se të dhënat e hapura janë një mjet, dhe jo një qëllim në vetvete. Diskutime të caktuara mbi këtë temë tregojnë se të dhënat e hapura mund ta përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve, por kjo nuk do të thotë në mënyrë të pashmangshme se do të përmirësojnë llogaridhënien e qeverive. Ndoshta, në këtë debat edhe më e rëndësishme është pyetja se si janë strukturuar të dhënat, si janë organizuar dhe publikuar? Dhe cili është rezultati përfundimtar? A shërbejnë ato për të rritur transparencën dhe llogaridhënien apo për të përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve⁸.

Ky është motivimi për përpjekjet tona për të filluar diskutimet mbi rëndësinë e të dhënave të hapura, por edhe të iniciojmë standarde të hapjes, që do të përmirësojnë transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve lokale, dhe më tej të të gjitha institucioneve shtetërore.

⁸Harlan Yu & David G. Robinson (2012), *The New Ambiguity of "Open Government"*, *UCLA Law review discourse*



PRAKTIKAT MË TË MIRA NË QEVERI TË E HAPURA DHE TË DHËNAT E HAPURA

Britania e Madhe është një nga pionierët në politikat dhe zbatimin e të dhënave të hapura në mbarë botën, ku sipas një studimi të veçantë⁹ përfitimet ekonomike të informatave të publikuara nga sektori publik në Britani të Madhe vlerësohen në rreth 1.8 miliard sterlina, me fitime sociale të rreth 5 miliard sterline.

Në kontekst të të dhënave të hapura në vetëqeverisjet lokale, një qasje interesante është zbatimi i Kodit të transparencës së vetëqeverisjeve lokale¹⁰. Bëhet fjalë për një dokument qeveritar, që ka për qëllim të sigurojë rritjen e ndikimit të qytetarëve, dhe kështu edhe me përgjegjësinë e tyre demokratike të përfshihen në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, të cilat do të ndihmojnë në formësimin dhe sigurimin e shërbimeve publike lokale.

Kodi, duke vendosur standardet për qasje në informatat dhe të dhënat e qytetarëve u siguron kushte për rolin e tyre më të madh dhe ndikimin në shoqëri.

Siç thuhet në Kod, disponueshmëria e të dhënave siguron përfitime të tjera pozitive. Mund të hapë tregje të reja për bizneset lokale, si dhe partneritet me bizneset dhe shoqërinë civile në ofrimin e shërbimeve lokale, ose në menaxhimin me financat publike.

Kodi përcakton termin “të dhëna” si të dhëna objektive, faktike mbi të cilat bazohen vendimet politike dhe mbi bazën e të cilave vlerësohen shërbimet publike, të cilat janë mbledhur ose të krijuara gjatë ofrimit të shërbimeve publike. Kjo duhet të jetë bazë për publikimin e informacionit mbi publikimin e funksioneve të pushtetit lokal.

Një studim i kryer nga Ipsos Mori¹¹, i prezantuar si argument në dokument, ka treguar sa më shumë qytetarët ndjehen të informuar, aq më shumë rritet tendenca që të jenë të kënaqur me shërbimet publike edhe nga autoritetet e tyre lokale.

⁹ “MarketAssessmentofPublicSectorInformation”, Deloitte, May 2013, https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/198905/bis-13-743-marketassessment-of-public-sector-information.pdf

¹⁰ LocalGovernmentTransparencyCode 2015, Department for Communities and Local Government, February 2015

¹¹ Whatdopeoplewant, needandexpectfrompublicservices?”, Ipsos MORI, 2010, http://www.ipsos-mori.com/DownloadPublication/1345_sri_what_do_people_want_need_and_expect_from_public_services_110310.pdf



Prandaj Qeveria britanike vlerëson se në parim, të gjitha të dhënat që i ka në dispozicion dhe i menaxhon pushteti lokal duhet të bëhen publike, përveç nëse nuk ka kushte të veçanta për ta bërë atë (p.sh. Mbrojtja e grupeve të cenueshme apo aspekte tregtare dhe operative). Ajo i inkurajon pushtetet lokale, që të dhënat t'i shohin si një burim i vlefshëm jo vetëm për veten e tyre, por edhe për partnerët e tyre dhe popullatën lokale.

Me miratimin e Kodit përcaktohen standardet për pushtetin lokal në Britaninë e Madhe për publikimin e një numër të madh të grupeve të të dhënave të hapura, duke përfshirë të dhëna mbi shpenzimet buxhetore (rreth 500 sterlina) dhe kontratat e lidhura, paga për pozita udhëheqëse, grante, pronë publike dhe fletëpronësi si dhe informacione të tjera. Kodi parashikon grupe të detyrueshme të të dhënave të cilat duhet të publikohen brenda një periudhe të caktuar, si dhe grupe të të dhënave për të cilat rekomandohet të publikohen nga pushtetet lokale, por që nuk janë të obligueshme.

Në të njëjtën kohë pushteti lokal inkurajohet nga Qeveria të kërkojë që të shkohet përtej asaj që e përcakton Kodi¹² në përputhje me parimin se të gjitha të dhënat që i ka në dispozicion dhe janë të menaxhuara nga pushteti lokal duhet të jenë të hapura dhe në dispozicion edhe për popullatën lokale, me disa përjashtime.

¹² https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/266815/Transparency_Code_Government_Response.pdf (see paragraph 37)



3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1. LËNDA, OBJEKTIVAT DHE DETYRAT E HULUMTIMIT

Mënyra në të cilën pushtetet lokale e realizojnë komunikimin e tyre me qytetarët dhe mënyra se si ata i përdorin teknologjitë moderne për të përmirësuar të informuarit *vis a vis* nevojat dhe interesat e qytetarëve për të dhëna dhe informacione nga lëmi të caktuara është subjekti kryesor drejt së cilit ishte drejtuar hulumtimi.

Hulumtimi synon të identifikojë fushat dhe konkretisht çështjet për të cilat pushteti lokal, në kuadër të kompetencave të tij, krijon të dhëna, si dhe të dhënat dhe informacionet për të cilat ekziston interes dhe nevojë e shprehur nga qytetarët dhe komuniteti i biznesit.

Objektivat e hulumtimit kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e liritimit e sa më shumë të dhënave dhe informatave që i ka në dispozicion pushteti lokal dhe në përgjithësi institucionet e shtetit, si një nga parakushtet themelore për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, por edhe kusht për lirinë e potencialit ekonomik të vendit.

Detyrat kryesore të hulumtimit:

- Të përcaktojë se çfarë është kuadri normativ për transparencë, llogaridhënie dhe të dhëna të hapura në nivel lokal *vis a vis* praktikës së publikimit të të dhënave nëpërmjet mediave elektronike
- Identifikimi i të gjitha llojeve të informacioneve dhe të dhënave të hapura për të cilat kanë nevojë qytetarët, të cilët mund të merren me anë të teknologjive digjitale, në mënyrë që të zhvillohen politikatat e ardhshme;
- Të përcaktojë se si është situata aktuale dhe ti identifikojë fushat për përmirësim sa i përket të të dhënave të hapura publike dhe informacioneve.

Hulumtimi është kryer në **tetë komuna të mëdha urbane, nga një nga çdo rajon planor** - Shkup, Manastir, Strumicë, Shtip, Kumanovë, Veles, Tetovë, Strugë, ku pritet një gatishmëri më e madhe dhe kapacitet për ti ndjekur teknologjitë e reja në mbledhjen proaktive dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informacioneve tek qytetarët.

3.2 KORNIZA HIPOTETIKE

Supozimi themelor nga i cili nisët hulumtimi është se hartimi dhe standardizimi i të dhënave të hapura dhe informacioneve që duhet publikuar pushtetet lokale do të mundësojnë:

- ndërtimin e një kornizë të përbashkët strategjike për të mundësuar përdorimin e unifikuar, të parashikueshëm dhe efikas të të dhënave publike në nivel lokal, sipas interesit dhe nevojave të qytetarëve dhe komunitetit të biznesit;



- përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit lokal, dhe kështu edhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet;
- forcimin e efikasitetit të politikave lokale për çështjet që janë po aq të rëndësishme dhe i prekin të gjithë, edhe qytetarët që jetojnë dhe punojnë në komunitet edhe për përfaqësuesit e pushtetit. Në këtë mënyrë raportet e ndërsjella do të marrin vlerë më të madhe;
- promovimin e vlerave demokratike, ku postulati kryesor është “qytetari është në rend të parë”, dhe pushtetet lokale kanë për detyrë të jenë aktiv në publikimin e të dhënave dhe informacioneve.

3.3. METODAT E HULUMTIMIT

Në kuadër të hulumtimit janë përdorë burimet primare dhe sekondare të të dhënave, që ishin përdorë më shpesh metodat e mëposhtme të hulumtimit dhe teknikat:

3.3.1 ANALIZA E DOKUMENTEVE

Hulumtimi është bazuar në analizën e kuadrit normativ dhe dokumentet strategjike në lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe obligimin për mbledhjen e të dhënave të hapura. Analiza e përfshiu të gjithë kuadrin përkatës ligjor me të cilën përcaktohet detyrimi i pushtetit lokal për të mbajtur shënime, regjistra dhe baza të të dhënave.

3.3.2. ANALIZA E STATUTEVE DHE FAQEVE TË INTERNETIT

Analiza e statuteve dhe faqet e internetit të tetë njësive të vetëqeverisjes lokale merret me analizën e të dhënave të publikuara në mënyrë elektronike vis a vis obligimit që dalin nga legjislacioni përkatës për transparencë si dhe për mbajtjen e shënimeve dhe regjistrave, si dhe mënyra këto detyrime të jenë të përfshira në aktin më të lartë të komunës - statutin.

3.3.3. ANALIZA E OPINIONIT PUBLIK

Analiza e opinionit publik bëhet përmes hulumtimit në terren - anketë e qytetarëve në komuna, për të përcaktuar prioritetet e qytetarëve për informacione dhe të dhëna nga vetëqeverisjet lokale.

Pyetësi për qytetarët ka për qëllim të përcaktojë se cilat, sipas mendimit të qytetarëve, janë informacione prioritare dhe të dhëna të cilat komuna është e detyruar ti vërë në dispozicion për publikun në 11 seksione tematike - (1) Financat Publike (2) Këshillit të NJVL-vendimet , kontaktet dhe komunikimi (3) zhvillimi ekonomik lokal (4) mjedisi jetësor (5) shërbimet komunale (6) kultura (7) arsimit (8) mbrojtja sociale dhe e fëmijëve (9) sporti (10) urbanizmi (11) ndërmarrjet dhe institucionet publike (bashkangjitur).



Me pyetësonin për qytetarët ishin të përfshirë dhe të shqyrtuar gjithsej 1330 anketues në terren. Anketën në terren e realizuan anketues në bazë të trajnimit të mëparshëm dhe udhëzimit, të emëruar nga organizatat e shoqërisë civile të përfshira në projekt.

3.3.4. ANALIZA E KAPACITETEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE

Pyetësoni për njësitë e vetëqeverisjes lokale ka për qëllim të përcaktojë kapacitetin e komunave (qendrat urbane) për mbledhjen e informacioneve të nevojshme për qytetarët dhe publikimin e tyre si grupe të të dhënave të hapura. Në fakt, përveç përcaktimit të gjendjes së TKI infrastrukturës në komuna, përcaktohet nëse ata i kanë të dhënat e identifikuar, në qoftë se i kanë të dhëna në çfarë forme janë (në letër, në formë elektronike, si raporte, në formë të strukturuar, si grupe të të dhënave, apo i ruajnë në një bazë të të dhënave elektronike).

Pyetësonin për komunat e plotësuan 7 komuna, nga gjithsej 8 të targetuara.

3.3.5 FOKUS GRUPE

Në mënyrë që të merret një analizë më e thellë e situatës në secilën nga tetë komunat ishin organizuar 8 fokus grupe në Shkup, Manastir, Strumicë, Shtip, Kumanovë, Veles, Tetovë, Strugë. Me fokus grupet ishin përfshirë gjithsej 80 të anketuar, apo 10 të anketuar në secilën komunë.

Në fokus grupin, në bazë të intervistës gjysmë të strukturuar, janë diskutuar nevojat, problemet dhe sfidat me të cilat përballen qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile në marrjen e informacionit dhe të dhënave, mënyrat e tejkalimit të tyre dhe propozime për përmirësimin e funksionimit të pushtetit lokal.

Gjatë zgjedhjes së fokus grupit insistohet që ai të jetë i ndryshëm në aspektin e gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, arsimit dhe pozitës së punës.

3.4 PËRPUNIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE

Për analizën statistikore të të dhënave është përdorur metodologji standarde dhe metoda statistikore të përshtatura për këtë lloj të hulumtimit me përcaktimin e renditjes së të dhënave më prioritare.

3.5. ORGANIZIMI DHE RRJEDHA E HULUMTIMIT

Hulumtimi paraqet një segment të rëndësishëm të realizimit të projektit “Qytetari në rend të parë”, Projekti është i financuar nga Delegacioni Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhjen e kontraktiveve (CFCD) dhe i bashkë-financuar



nga Ambasada Britanike, nën drejtimin e “Qendrës për Menaxhimin e Ndryshimeve” (QMN) dhe në bashkëpunim me “Qendrën për zhvillimit të qëndrueshëm ALKA.”

Në përgatitjen e metodologjisë së hulumtimit, përveç ekspertëve kontribut dhanë përfaqësues të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministrisë së vetëqeverisjes lokale, bashkëpunëtorë dhe anëtarë të Këshillit menaxhues të projektit.

Hulumtimi u realizua në periudhën nga muaji shkurt deri në qershor të vitit 2016, në Republikën e Maqedonisë.



4. ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

4.1. MJEDISI I MUNDËSISË - ANALIZA E KORNIZËS AKTUALE LIGJORE, DOKUMENTEVE, PRAKTIKAT / PROTOKOLLEVE PËR TRANSPARENCËS

Analiza reflektohet në kornizën **normative në Maqedoni** (Kushtetutë, Ligjin për Vetëqeverisje lokale, Ligji për qasje të lirë në informacione të karakterit publik, Ligji i mbrojtjes së të dhënave personale, Ligji i përdorimit të të dhënave nga sektori publik) dhe **dokumenteve strategjike** (Programi për zhvillimin lokal dhe decentralizimi i Republikës së Maqedonisë 2015-2020, Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale, Protokollin shtesë i Kartës Evropiane të vetëqeverisjes lokale në të drejtën për të marrë pjesë në punët e pushtetit lokal, Strategjia e inovacioneve dhe qeverisjes së mirë në nivel lokal e Këshillit të Evropës) që merret me çështjet e transparencës, llogaridhënies, qasjen në informacione dhe të dhëna në nivel lokal duke përdorur teknologji të reja. Në të njëjtën kohë, ishin analizuar edhe ligjet përkatëse që përcaktojnë detyrimin për njësitë e vetëqeverisjes lokale për të mbajtur shënime, regjistra dhe bazat e të dhënave në fushën e juridiksionit të tyre, si: planifikimi urbanistik (urban dhe rural), rregullimin e hapësirës dhe tokës ndërtimore; mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës; zhvillimi ekonomik lokal; shërbimet komunale; kultura; sporti dhe rekreacioni; mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve; arsimit fillor dhe i mesëm; kujdesi shëndetësor; mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve dhe mallrave; mbrojtja nga zjarri; dhe çështje të tjera të përcaktuara me ligj.

Republika e Maqedonisë ka një vetëqeverisje lokale njëshkallëshe që është e bazuar në parimin subsidiar, të organizuar në 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit, si njësi e veçantë e pushtetit lokal, që rezulton nga karakteri i Qytetit të Shkupit, si kryeqytet i Republikës së Maqedonisë¹³. 34 njësitë e vetëqeverisjes lokale janë me seli në qytet, dhe 46 të tjerat janë me seli në fshat.

Sipas të dhënave nga vlerësimi i popullsisë së Entit Shtetëror të Statistikës, në vitin 2013, popullsia e përgjithshme në shtet është 2,064,032 banorë. Treguesit demografikë tregojnë dallime të rëndësishme që tregojnë pabarazi në shpërndarjen territoriale të popullsisë. 57.8% e popullsisë së përgjithshme jeton në qytete, me përqendrim më të madh në qytetin e Shkupit dhe 13 qytete në të gjithë vendin që kanë mbi 50,000 banorë.

¹³ Ligji për organizim territorial i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM-së nr.55/04;12/05;98/08;106/08;149/14;)



E drejta për informim të rregullt të publikut për punën e pushtetit lokal është rregulluar me Ligjin për vetëqeverisje lokale¹⁴ që përcakton detyrimin e organeve komunale (Kryetarit dhe Këshillit), komisionet e këshillit dhe shërbimet publike të themeluara nga komunitat pa kompensim ti informojnë qytetarët për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë të rëndësishme për zhvillimin e komunës, në mënyrën e përcaktuar me statut; Në të njëjtën kohë, BNJVL-ja thekson se komuna është e obliguar qytetarëve t'u sigurojë qasje në informatat bazë për shërbimet që ua ofron, në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me statut.

Përveç që rregullon mënyrën e ushtrimit të së drejtës për qasje në informacionin publik, Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik¹⁵ i përcakton informacionet që poseduesit e informacioneve, duke përfshirë njësitë e vetëqeverisjes lokale është e nevojshme ti publikojnë në faqet e tyre të internetit:

- aktet ligjore dhe nënligjore
- njoftime për publik për punët e kryera nga ana e tyre, në përputhje me përgjegjësitë ligjore;
- të dhëna statistikore për punën e vet;
- Raportet mbi punën që ata i dorëzojnë tek organet përkatëse zbatimit e mbikëqyrjes dhe kontrollit dhe mënyrës tjetër të paraparë me ligj, që ti vënë në dispozicion të gjitha informacionet me karakter publik;
- Propozim programet, programet, strategjitë, qëndrimet, mendimet, studimet dhe dokumentet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me kompetencën e poseduesit të informacionit;
- të gjitha thirrjet për procedurat e prokurimit publik dhe dokumentacionin e tenderit, si dhe
- informacione të tjera që kanë të bëjnë me kompetencat dhe punën e tyre.

Me **ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik** përcaktohet detyrimi i autoriteteve dhe institucioneve të sektorit publik për të publikuar të dhëna (në format kompjuterik) që i krijojnë në realizimin e kompetencave të tyre në përputhje me ligjin, në mënyrë që të mundësohet përdorim (pa pagesë dhe lirshëm) i të dhënave nga persona juridik ose fizik për krijimin e informacioneve të reja, përmbajtjeve, aplikimeve ose shërbimeve.

Nga **disa ligje të caktuara konkrete**, për njësitë e pushtetit lokal rezultojnë obligime për mbajtjen e regjistrave apo shënimeve në fusha të ndryshme. Në përputhje me ligjin, në mënyrë që të mundësohet përdorim (pa pagesë dhe lirshëm) i të dhënave nga persona juridik ose fizik për krijimin e informacioneve të reja, përmbajtjeve, aplikimeve ose shërbimeve.

Në tabelën 1 është dhënë një pasqyrë e përgjegjësive për mbledhjen e të dhënave dhe mbajtjen e shënimeve të cilat janë obligim i njësisë të vetëqeverisjes lokale.

Këto të dhëna dalin nga puna e njësisë të vetëqeverisjes lokale dhe për këtë arsye nuk ka asnjë kufizim për zbulimin e tyre publik, veç nëse nuk ka kufizime që dalin nga **Ligji për Mbrojtjen e të dhënave personale**.

¹⁴ Neni 8 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

TABELA NR. 1 – Pasqyra e evidencave që janë obligim për vetëqeverisjet lokale nga ligjet konkrete

SFERA	EVIDENCA / AKTI LIGJOR (BAZA)	AKTI NËNLIGJOR
Menaxhimi financiar publik lokal	<p>Regjistri i pronës së patundshme dhe regjistri i pronës së tundshme</p> <p>Neni 10 paragrafi (5) dhe neni 39 paragrafi (4) të Ligjit për tatime mbi pronë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2004)</p>	<p>Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe regjistrit të pronës së patundshme dhe regjistrit të pronës së tundshme (Ministria e Financave, nr. 1016276/2 nga viti 2005)</p>
Zhvillimi ekonomik lokal	<p>Regjistri i personave fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari turistike me vëllim të vogël</p> <p>Neni 3 paragrafi 4 të Ligjit për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2004)</p> <p>Regjistri i personave fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari hoteliere me vëllim të vogël</p> <p>Neni 4 paragrafi 3 të Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2004)</p> <p>Regjistri i objekteve të kategorizuara hoteliere</p> <p>Paragrafi 1 neni 47-a të Ligjit për veprimtari hoteliere</p> <p>Evidenca e hoteliereve</p> <p>Neni 8, Ligji për veprimtari hoteliere</p> <p>Evidenca për orarin e punës së objekteve hoteliere</p> <p>Neni 25, Ligji për veprimtari hoteliere</p> <p>Regjistri i zonave të gjelbra industriale¹⁴</p> <p>Neni 13, Ligji për zona të gjelbra industriale</p>	<p>Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të personave fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari turistike me vëllim të vogël (Ministria e Ekonomisë, nr. 13-7618/1 nga viti 2006)</p> <p>Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të personave fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari hoteliere me vëllim të vogël (Ministria e Ekonomisë, nr. 13-7618/1 nga viti 2006)</p> <p>Rregullorja për kushtet e kategorizimit të objekteve për ushtrimin e veprimtarisë hoteliere (Gazeta Zyrtare, nr. 16/2006)</p>



SFERA	EVIDENCA / AKTI LIGJOR (BAZA)	AKTI NËNLIGJOR
Mjedisi jetësor	<p>Regjistri i ndotësve</p> <p>Neni 41, Ligji për mjedisin jetësor</p> <p>Regjistri i elaboreve të miratuara për mbrojtjen e mjedisit</p> <p>Neni 24 paragrafi 3 të Ligjit për mjedisin jetësor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11 dhe 123/12)</p> <p>Evidenca e vetme për edukimin e zbatuar</p> <p>Neni 204-a paragrafët (3) dhe (10) të Ligjit për mjedisin jetësor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10 dhe 51/11)</p> <p>Kadastra për mjedisin jetësor</p> <p>Neni 41, Ligji për mjedisin jetësor</p> <p>Raporti për gjendjen e mjedisit jetësor</p> <p>Paragrafët 5 dhe 6, neni 45, Ligji për mjedisin jetësor</p> <p>Regjistri i qytetit i B-lejeve të integruara ekologjike</p> <p>Paragrafi 5, neni 126, Ligji për mjedisin jetësor</p> <p>Kadastra e krijesve të zhurmës në mjedisin jetësor</p> <p>Neni 35, Ligji për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor</p>	<p>Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e elabوراتit për mbrojtjen e mjedisit jetësor në pajtim me llojet e veprimtarive apo aktiviteteve për të cilat hartohet elabوراتi, si dhe në pajtim me ushtruesit e veprimtarisë dhe vëllimit të veprimtarive dhe aktiviteteve që i ushtrojnë personat juridikë dhe fizikë, procedurën për miratimin e tyre, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për elabوراتet e miratuara (Gazeta Zyrtare, nr. 44/2013)</p> <p>Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, mënyrën e zbatimit të edukatës, si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së vetme për edukimin e zbatuar (Numri i Gazetës Zyrtare: 118/2011)</p>

14 Nëse themelues i zonës është Qeveria e Republikës së Maqedonisë e mban Drejtoria, kurse për ndërtimet në zonat e gjelbra industriale për të cilat është lidhur marrëveshje për partneritetin privat publik, Regjistrin e mban Ministria e Ekonomisë, e nëse themelues është njësia e vetëqeverisjes lokale, Regjistrin e mban Ministria e Vetëqeverisjes Lokale



SFERA	EVIDENCA / AKTI LIGJOR (BAZA)	AKTI NËNLIGJOR
<p>Veprimtaritë komunale</p>	<p>Sistemi informativ në nivel lokal, me të cilin sigurohet grumbullimi dhe prezantimi i të dhënave për gjendjen e përgjithshme në lidhje me menaxhimin me hedhurinë e parrezikshme</p> <p>Neni 113 të Ligjit për menaxhimin me hedhurinë</p> <p>Regjistri i hedhurinës¹⁵</p> <p>Neni 115 të Ligjit për menaxhimin me hedhurinë</p> <p>Kadastra e krijesve të hedhurinës</p> <p>Neni 116 të Ligjit për menaxhimin me hedhurinë</p> <p>Evidenca për transportierët dhe automjetet motorike të regjistruara për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe mallit në komunikacionin rrugor në varësi nga lloji i transportit</p> <p>Neni 13 të Ligjit për transport në komunikacionin publik</p> <p>Evidenca dhe regjistri i emrave të rrugëve dhe numrave të objekteve</p> <p>Neni 17, Ligji për caktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore</p>	<p>Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së evidencës në regjistrin e hedhurinës (Gazeta Zyrtare, nr. 39/2009)</p> <p>Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e lejes, kërkesës dhe regjistrit për lejet e lëshuara për tregtinë me hedhurinë e parrezikshme, mënyrën dhe procedurën për lëshimin e lejes, mënyrën e mbajtjes së evidencës, si dhe kushtet për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së tregtisë me hedhurinë e parrezikshme (Gazeta Zyrtare, nr. 115/2007)</p>
<p>Kultura</p>	<p>Regjistri i përmendoreve memoriale dhe pllakave përkujtimore</p> <p>Neni 20, paragrafi 4 të Ligjit për përmendoret memoriale dhe pllakat përkujtimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/04)</p> <p>Mbajtja e evidencës dhe dokumentacionit të muzeut</p> <p>Neni 20 të Ligjit për muzetë</p> <p>Evidenca dhe dokumentacioni i fondit të bibliotekës</p> <p>Neni 21 të Ligjit për biblioteka</p>	<p>Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së përmendoreve memoriale dhe pllakave përkujtimore (Ministria e Kulturës, nr. 30-5862/7 nga viti 2005)</p>



SFERA	EVIDENCA / AKTI LIGJOR (BAZA)	AKTI NËNLIGJOR
Arsimi	<p>Regjistri i shkollës fillore</p> <p>Neni 19 paragrafi 5 dhe neni 22 paragrafi 3 të Ligjit për shkollën fillore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/08, 35/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13)</p> <p>Regjistri i shkollës së mesme</p> <p>Neni 19 paragrafi 6 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07 dhe 49/07)</p>	<p>Rregullorja për mënyrën e verifikimit të shkollës fillore dhe formën, përmbajtjen, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror dhe regjistrit komunal të shkollave fillore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 19 nga 29.01.2014)</p> <p>Rregullorja për mënyrën e verifikimit të shkollës së mesme dhe për mënyrën e mbajtjes së regjistrave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 81/2007, dhe nr. 98/2013)</p>
Sporti	<p>Evidenca e inventarit të objekteve sportive në pronësi të komunës</p> <p>Neni 13, Ligji për sport (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 29/2002,66/2004,83/2005,81/2008,18/2011,51/2011,</p> <p>64/2012,148/2013,187/2013,42/2014,138/2014,177/2014, 72/2015,153/2015,6/2016,55/2016,61/2016,106/2016)</p>	<p>Dekreti për klasifikimin e objekteve për sport me rëndësi nacionale dhe lokale në pronësi të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare, nr. 27/2016)</p>

¹⁵ E mban Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor



SFERA	EVIDENCA / AKTI LIGJOR (BAZA)	AKTI NËNLIGJOR
Urbanizmi	<p>Evidenca për dokumentacionet e planit urbanistik të miratuara shtetërore dhe lokale</p> <p>Paragrafi 12, neni 50-a, Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 199/2014)</p> <p>Evidenca elektronike e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturure, numrave për numërimin e objekteve dhe për përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit elektronik</p> <p>Neni 26, paragrafi 3 të Ligjit për caktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturure (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 66/2004 dhe 55/2007)</p> <p>Themelimi dhe mbajtja e regjistrit të ndërtesave banesore dhe ndërtesave dhe regjistrit të drejtuesve të ndërtesave banesore</p> <p>Nenet 112-114, Ligji për banim (Gazeta Zyrtare, nr. 99/2009)</p>	<p>Rregullorja për përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës elektronike të emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturure, numrave për numërimin e objekteve dhe për përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit elektronik (Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, nr. 02-14063 nga viti 2007)</p> <p>Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të ndërtesave banesore dhe ndërtesave dhe regjistrit të drejtuesve të ndërtesave banesore (Gazeta Zyrtare, nr. 88/2010)</p>
Kopshtet për fëmijë dhe institucionet tjera për fëmijë	<p>Regjistri i institucioneve publike për fëmijë të themeluar nga komuna dhe komuna në Qytetin e Shkupit</p> <p>Neni 73 paragrafi 9 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 98/00, 17/03 ,65/04 dhe 113/05)</p>	<p>Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave të institucioneve për fëmijë (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, nr. 11-3-16/2)</p>



Nevoja nga përforcimi i kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes lokale për menaxhim të mirë, para se gjithash, në pjesën e transparencës dhe raportimit, si dhe sigurimit të e-shërbimeve është një caktim strategjik në dokumentet dhe strategjitë nacionale dhe ndërkombëtare kryesore.

Në dokumentet e Këshillit të Evropës¹⁶, njëra ndër parimet themelore për menaxhim demokratik në nivel lokal janë transparenca dhe participativiteti. Insistohet në qasjen publike në të gjitha informatat që nuk janë të klasifikuara. Informatat për vendimet, për zbatimin e politikave dhe rezultateve të jenë të arritshme për opinionin, në mënyrën që mundëson në mënyrë efikase të ndiqet dhe të kontribuohet në punën e pushtetit lokal. Pastaj, posaçërisht të theksohet et nevoja e qasjes inovative dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja.

Publikimi i të dhënave të hapura në klasifikimin e BE-së, gjithashtu, trajtohet si e-shërbim. Programi për zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe decentralizimin 2015-2020 i thekson aktivitetet me të cilat mbështetet transformimi i administratës lokale të orientuar te qytetarët dhe sektori privat, dhe i cili është i aftë në tërësi të inkorporohet në hapësirën administrative evropiane. Në këtë kontekst pritet që zbatimi i Programit të rezultojë edhe me zhvillimin e kapaciteteve të administratës lokale për zbatimin e mekanizmave për komunikimin proaktiv me qytetarët dhe sigurimin e pjesëmarrjes së vazhdueshme të tyre në procesin e vendimmarrjes për çështjet me rëndësi lokale, si dhe informimin për shpenzimin e mjeteve financiare publike në nivel lokal.

Strategjia për inovacion dhe menaxhim të mirë në nivel lokal flet për parimet e menaxhimit demokratik që shërbejnë si përcaktues për punën e pushtetit lokal, në mesin e të cilave për qasje publike të të gjitha informatat që nuk janë të klasifikuara dhe ajo që është më e rëndësishme, informatat për vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultateve të jenë të arritshme për opinionin, në mënyrën që mundëson në mënyrë efikase të ndiqet dhe të kontribuohet në punën e pushtetit lokal.

Në Statutet e komunave, çështja e opinionit është hartuar në nivelin e konkretizimit të punëve për të cilat, komuna në pajtim me Ligjin, ka për detyrë t'i informojë qytetarët.

Në këtë kontekst mendohet në rregullat që i miraton Këshilli i Komunës; mënyra dhe kushtet për realizimin e të drejtave të qytetarëve; planet, projektet dhe programet të cilat janë në përgatitje, e të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e Komunës; shërbimet që i marrin nga shërbimet publike dhe administrata komunale dhe mënyra e marrjes së tyre; të ardhurat që realizohen në Komunë dhe mënyra e shpërndarjes dhe shpenzimit të tyre; furnizimet publike të mjeteve themelore për punë; emërimi i drejtorëve dhe përfaqësuesve në këshillat administrativë të ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe shkollave; informatat tjera që dalin nga kompetenca e organeve të Komunës dhe ndërmarrjet dhe institucionet publike në pajtim me ligjin.

¹⁶ Konventa Evropiane për Vetëqeverisje Lokale është miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 1985, të cilën Kuvendi i RM-së e ratifikoi më 06.06.1997, kurse hyri në fuqi më 01.10.1997 dhe protokollin plotësues në Konventën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale për të drejtën e pjesëmarrjes në punët e pushtetit lokal, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 130 nga 31.7.2015



Statutet parashikojnë më tepër mënyra të informimit, si për shembull – botimi i Gazetës Zyrtare të komunës, botimi i publikimeve; zyrat informative të mbajtura nga administrata komunale dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna; tabelat e shpalljes (lokalet e komunës, ndërmarrjet publike, institucionet dhe vetëqeverisja lokale); faqja e internetit; tribunat publike; mjetet për informim publik dhe në mënyrën tjetër përkatëse që është më i volitshëm për informimin e opinionit. (Pasqyra e komunave, shtojca)

SHQYRTIMET KRYESORE

- Hulumtimi tregoi se edhe pse nuk ekziston kornizë juridike të determinuar formale e cila siguron standarde për transparencë në nivel lokal, përsëri në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për qasje të lirë te informatat, si dhe në Ligjin për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik, janë krijuar kushtet normative për sigurimin e qasjes së plotë (me përjashtime saktë të përkufizuara) në informatat për punën e pushtetit lokal, në mënyra të ndryshme, me qëllim të sigurohet transparenca dhe raportimi në punë dhe të nxitet participativiti në nivel lokal.
- Ligji për vetëqeverisje lokale është decid në lidhje me detyrën e NJVL-së/komunals qđ qytetarıve t'u mundlısojl qasjen nl informatat themelore prr shlr-bimet qđ ua siguron, nl mlınyrlınl dhe me kushtet e prlcaktuara me statutın. Gjithashtu, insiston nl informimin e opinionit prr punınl e organeve tl komunals (kryetari i komunals dhe klshilli) sl komisioneve tl klshillit dhe shlr-bimeve publike.
- Në përgjithësi, në Statutet e komunave nuk ka të përkufizuar konkretisht se cilat informata kur dhe ku saktë do të publikohen, që informimin e bën të paparashikueshëm. Gjithashtu, faqja e internetit e komunës nuk është theksuar si vend në të cilin detyrimisht do të publikohen të gjitha informatat, kurse mënyrat tjera si alternativë për qytetarët nga shkaqet të ndryshme nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë teknologji të TI-së.
- Nga ligjet e veçanta konkrete, për njësitë e vetëqeverisjes lokale dalin obligimet për mbajtjen e regjistrave dhe evidencave në sfera të ndryshme. Në këtë mënyrë NJVL-të / komunat kanë obligim të sigurojnë të dhëna shumë të rëndësishme dhe të dobishme që dalin nga kompetencat dhe puna e tyre dhe të cilat mund shumë të shërbejnë në krijimin e politikave lokale në sferat e caktuara.
- Ligji për qasje të lirë te informatat me karakter publik nuk është obligues deri në fund në formulimin se poseduesit e informatave “nevojitet” t'i publikojnë aktet ligjore dhe nënligjore, njoftimet dhe dokumentet tjera në faqen zyrtare të internetit të institucionit, edhe pse ndihmon në përkufizimin e informatave të cilat qytetarët duhet të kenë qasje në faqen e internetit të komunës.
- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale praktikisht mundëson të drejtën e qasjes së lirë te informatat me karakter publik që të shfrytëzohet pa kufizim, përveç nëse bëhet fjalë për të dhënat personale. Edhe në këtë rast, Ligji lejon përpunimin (publikimin) e të dhënave personale për përmbushjen e



obligimit ligjor të kontrolluesit (poseduesi i informatës), si dhe për realizimin e punëve me interes publik apo me autorizimin zyrtar të poseduesit të informatës, përveç nëse liritë dhe të drejtat e subjektit të të dhënave personale nuk mbizotërojnë mbi interesat e tilla, që në esencë vetëm në situatat e jashtëzakonshme e kufizon të drejtën e qasjes së lirë të informatat me karakter publik.

- Ligji për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik përcakton, jo mundësi, por obligim të organeve dhe institucioneve nga sektori publik për shpalljen publike të të dhënave që i krijojnë në realizimin e kompetencave të tyre në pajtim me ligjin, me qëllim të mundësojnë shfrytëzimin e këtyre të dhënave nga personat juridikë apo fizikë për krijimin e informatave, përmbajtjeve, aplikimeve apo shërbimeve të reja (të dhënave të hapura). Në lidhje me sektorin publik, Ligji e saktëson përfshirjen e organeve të pushtetit shtetëror dhe organeve dhe organizatave tjera të përcaktuara me ligj, organeve të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, institucioneve dhe shërbimeve publike, ndërmarrjeve publike, personave juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë autorizime publike të përcaktuara me ligj. Madje, ligjvënësi ka paraparë edhe sanksione për moszbatimin e ligjit.
- Analiza e Statuteve të komunave tregon se ky obligim ligjor (publikimi i të dhënave nga sektori publik në formatin e hapur dhe të përpunuar në makinë) në përgjithësi nuk është përpunuar në aktin më të lartë juridik të komunës. Gjithashtu, qasjen në të dhënat e hapura apo informatën për qasjen në to nuk ka në faqet e internetit të njësive të vetëqeverisjes lokale.

4.2. ANALIZA E PUBLIKUT NË PUNËN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE, PËRMES FAQEVE TË INTERNETIT TË NJVL-SË

Kjo pjesë e raportit përqendrohet në të dhënat dhe informatat që janë marrë përmes observacionit dhe analizës së Statuteve të NJVL-së në lidhje me transparencën, në përgjithësi për punën e komunave / Qytetit të Shkupit, por edhe transparencën dhe raportimin në lidhje me çështjet e caktuara nga kompetenca lokale, e cila bazë është sqaruar më lartë në raport.

ÇKA TREGOJI HULUMTIMI?

Rezultatet e analizës së transparencës së NJVL-së përmes pasqyrës së faqeve të internetit të NJVL-së janë paraqitur në vazhdim. (Rezultatet e paraqitura janë nxjerrë edhe në bazë të vlerësimit të mënyrës së kërkimit dhe qasjes në informata. Disa nga të dhënat mund të gjenden përmes kërkimit të Gazetave Zyrtare të Komunës, si vendimet e Këshillit, por edhe pse janë të rëndësishme për qytetarët, nuk janë të dukshme në faqen e internetit të NJVL-së)

TË ARRITSHME PËRMES FAQES SË INTERNETIT (PO/JO)	QYTETI I SHKUPIT	VELES	SHTIP	STRUMICË	MANASTIR	TETOVË	KUMANOVË	STRUGË	Legjenda: ✓ Po ✗ Jo ✗ Pjesërisht			
									✓	✗	✗	
Statuti	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Gazetat Zyrtare	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Informatat për anëtarët e Këshillit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Informatat për mbledhjet e Këshillit	✗	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Administrata - organizimi dhe kontaktet	✓	✓✗	✓	✓	✓✗	✓✗	✓✗	✓✗	✓✗	✓✗	✓✗	✓✗
Projekt-buxheti	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Buxheti i miratuar	✓	✓	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Llogaria përfundimtare	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Plani për furnizimet publike	✗	✓	✓	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Raporti për realizimin e furnizimeve publike	✗	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Raporti i Entit Shtetëror të Revizionit	✗	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Ndërmarrjet publike (linku, kontakti, raportet)	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Pronë e patundshme në pronësi të komunës	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗

Informatat e përgjithshme për komunën



Analiza tregon se të gjitha NJVL-të i publikojnë Gazetat Zyrtare, por në mënyrë të ndryshme dhe në mënyrë kronologjike, me fillim të ndryshëm të publikimit të tyre elektronik. Emrat e anëtarëve të këshillave në numrin më të madh të rasteve janë publikuar me kontakte (adresa elektronike). Vetëm një NJVL paraprakisht i njofton mbledhjet e Këshillit me publikimin e rendit të ditës, kurse asnjë NJVL nuk ka të publikuar procesverbale nga mbledhjet e Këshillit.

Nuk ka informata për punën e trupave të përhershme të Këshillit të NJVL-së, e as për punën e trupave konsultuese: Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Këshilli i Konsumatorëve, Komisioni për Mundësi të Barabarta, Trupi Participues nga Sfera e Urbanizmit.

Të gjitha NJVL-të, edhe pse në mënyrë të ndryshme, e kanë publikuar organizimin e administratës komunale me kompetencat e sektorëve dhe kontakteve me udhëheqësit e sektorëve.

Informata të servisit më së shumti siguron Qyteti i Shkupit me linqe në faqet e internetit të ndërmarrjeve publike, shumë më pak të tjerat të cilat kanë vetëm informata të përgjithshme për ndërmarrjen publike (adresë, telefon).

Në përgjithësi, në faqet e internetit të NJVL-ve ka informata vetëm për emrat e shkollave publike (fillore dhe të mesme). Vetëm dy NJVL kanë të dhëna edhe për numrin e paraleleve dhe nxënësve.

NJVL-të, përveç njëres, në përgjithësi i publikojnë emrat e organizatave joqeveritare me të cilat bashkëpunojnë. Bashkëpunimi kryesisht është prezantuar përmes emrit të OC-ve dhe projektit, por jo edhe me vëllimin e mjeteve financiare.

Të gjitha komunat dhe Qyteti i Shkupit, me përjashtim të njëres, kanë publikuar hartë me emrat e rrugëve dhe legjendë të përmendoreve me rëndësi historike kulturore.

Të gjitha NJVL-të kanë publikuar informata për bashkëpunim ndërkombëtar me komunat e vendeve tjera.

Nuk janë publikuar regjistrat, e as të dhënat nga regjistrat që NJVL-të me ligj obligohen t'i mbajnë, përveç regjistrit të transportierëve të taksive të licencuar dhe pjesërisht të subjekteve të cilave u janë lëshuar B-lejet e integruara ekologjike (plotësisht vetëm Qyteti i Shkupit).

Në përgjithësi, në të gjitha faqet e internetit janë theksuar të dhënat për personin zyrtar për qasjen e lirë të informatat me kontakt, por jo edhe lista e informatave.

Të gjitha NJVL-të i publikojnë PGJU-të dhe PDU-të, por jo edhe kur janë në formën e propozimit.

Vetëm një komunë ka publikuar bashkësitë lokale dhe urbane ekzistuese në komunë, por pa kontakte.

Të gjitha NJVL-të kanë publikuar të dhënat themelore për zonat industriale, pa detajet e kapaciteteve dhe kushteve.

Në të gjitha faqet e analizuara të internetit informacioni mbi projektet e realizuara dhe ato aktuale në komunë nuk janë të sistematizuara dhe nuk është treguar struktura financiare e projektit. Zakonisht ka informacione mbi projektet për bashkëpunim ndërkufitar të financuara nga BE-ja.



Asnjë NJVL nuk ka publikuar kalendar të aktiviteteve.

Buxheti i NJVL-ve në shumicën e rasteve publikohet pas disa viteve, por jo edhe propozim buxheti si dhe raporti përfundimtar, dhe vetëm pjesërisht Raporti vjetor për zbatimin e Buxhetit. Planet për prokurime publike në shumicën e rasteve janë të publikuara, por jo edhe raportet mbi zbatimin e tyre. Edhe pse prokurimi publik në Republikën e Maqedonisë zyrtarisht publikohet në sistemin e prokurimit elektronik (<https://e-nabavki.gov.mk>) në Byronë e prokurimit publik, ata nuk janë të publikuara në faqet e internetit të komunave, duke i bërë ato të dhëna pak të kapshme. Komunat nuk publikojnë informacione mbi prokurimin publik të realizuar. Nuk ka informacione mbi revizionin e kryer në komunë nga ana e ESHR ose nga një revizion i pavarur.

Informacioni për qasje në shërbimet nëpërmjet faqes së internetit të NJVL-së, të gjitha komunat, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, e bëjnë në mënyrë të ndryshme.

Komunat Strumicë dhe Shtip kanë listën e shërbimeve të ofruara nga komuna dhe formular që dorëzohen në sportel. Komuna Velesit ka publikuar kartelat e shërbimeve (përshkruhet në detaje mënyra dhe dokumentet për sigurimin e shërbimeve) pa një listë e cila ofron një pasqyrë të shërbimeve të ofruara nga komuna. Shërbimet nuk janë të sistematizuara në kuptimin cilat prej tyre janë të destinuara për qytetarët, dhe cilat për personat juridikë. Nuk ka mundësi që të dorëzohen dokumentet në mënyrë elektronike, dhe mundësia e monitorimit elektronik të statusit të aplikimit është shumë e kufizuar.

Komunikimi interaktiv me qytetarë realizohet përmes mundësisë së përdorimit të e-aplikimit Denonco problem (Projekti i financuar nga USAID) dhe në komunën e Strumicës edhe përmes aplikimeve Pyetni kryetarin dhe Takim me kryetarin e komunës. Nuk ka mjete për anketa elektronike, forume, konsultime ose propozime nga qytetarët. Nuk janë të publikuara pyetjet që janë parashtruar më shpesh.

NJVL në faqet e tyre nuk kanë publikuar informacionin në formatin e të dhënave të hapura si dhe as link deri te platforma e internetit ku të dhënat mund të publikohen.



VËREJTJET KRYESORE

- Faqja e internetit e NJVL-së në Statutin e NJVL-së është theksuar si një nga mënyrat për të informuar qytetarët për punën e organeve komunale dhe shërbimet e ofruara së bashku me shërbimet publike. Kjo do të thotë se informacionin për punën e komunës publiku mund ta sigurojë duke postuar informacione në tabelat e shpalljeve, në buletin, tubim të qytetarëve, në debate publike dhe mënyra tjera, që është në kundërshtim me trendet aktuale në dokumentet evropiane për inovacion dhe përdorimin e teknologjive të reja (internet dhe e-mjete) në dhënien e informacionit dhe komunikimin e pushtetit lokal me qytetarët.
- Komunat urbane dhe Qyteti i Shkupit (ata që janë subjekt i analizës) kanë faqe teknikisht të mira të internetit të cilat janë përditësuar rregullisht dhe në mënyrë të ndryshme përpiqen të sigurojnë transparencën e punës dhe komunikimit me qytetarët. Megjithatë, mënyra e publikimit të tyre është e fragmentuar, që tregon se ka standarde që do sigurojnë mënyra unike të publikimit të grupeve të caktuara të informacionit në faqet e internetit të të gjitha komunave.
- Në përgjithësi nëpër faqet e internetit, komunat dhe Qyteti i Shkupit sigurojnë transparencë të pjesshme, por llogaridhënie minimale, me mundësi shumë të kufizuara për komunikim të dyanshëm dhe pa mjete elektronike për konsultim me qytetarët. Nuk ka pasqyrë të qartë të shërbimeve të ofruara nga NJVL dhe formularët e publikuar nuk mund të dorëzohen elektronikisht, apo të ndiqet statusi i lëndës.



4.3 ÇFARË MENDOJNË QYTETARËT


VËREJTJE TË PËRGJITHSHME

Të gjitha fushat e mësipërme të të dhënave/informacioneve u renditën nga qytetarët në disa kategori “Shumë e rëndësishme”, “E rëndësishme”, “Jo aq e rëndësishme”, “Asnjë rëndësi” dhe “Pa opinion”.

Në grafikun e mëposhtëm tregohet numri i përgjigjeve të qytetarëve sipas kategorive:

PYETJA 33.

Fushat e të dhënave/informacioneve të renditura sipas qytetarëve, në përputhje me përgjigjen “Shumë e rëndësishme”



Përgjigjet tregojnë se më të rëndësishme për qytetarët janë informacionet e fushës së arsimit, financave dhe mbrojtjes sociale.

Nga ana tjetër, administrata në njësitë e vetëqeverisjes lokale vlerëson se të dhënat më të rëndësishme për qytetarët janë të dhënat e shërbimeve, të sportit dhe të financave.

Grafiku i mëposhtëm tregon rezultatet përmbledhëse të informacionit të marrë nga NJVL, për atë në çfarë forme i kanë të dhënat të identifikuar gjatë analizës.



Përqindjet tregojnë shkallën e posedimit të të dhënave, gjegjësisht:


0% - komuna aspak nuk i ka ato të dhëna;

25% - komuna i ka të dhënat vetëm në formë të letrës;

50% - Komuna i ka të dhënat në formë elektronike si raportet (Word, PDF ...);

75% - komuna i ka të dhënat në formë elektronike të strukturuar (grup i të dhënave);

100% - Komuna i ka të dhënat në një formë të strukturuar dhe i ruan në një bazë të dhënash elektronike.



Nga grafiku shihet se rezultatet më të mira totale, apo në formën më të përparuar janë të dhënat e identifikuara nga fusha e shërbimeve, sport, këshilla, financa dhe kulturë. Rezultatet më të ulëta janë në fushën e mjedisit jetësor ose komunat më pak mbledhin të dhëna në këtë fushë, ose i ruajnë vetëm në formë letre.



FINANCA

Nga fusha e financave, shumica e të anketuarve besojnë se më shumë kanë nevojë, apo i kanë renditur si shumë të rëndësishme dhe të rëndësishëm të dhënat e mëposhtme:

- Propozim- Buxheti i NJVL
- Buxheti i miratuar i NJVL-së
- Llogaria përfundimtare
- Buxheti i propozuar dhe i miratuar civil
- Raportimi i realizimit të prokurimeve publike.

Nevojat për këto të dhëna që kanë të bëjnë me transparencën fiskale të vetëqeverisjes lokale janë në përputhje me të gjeturat nga fokus grupet e realizuara, ku theksohej nevoja për të dhëna mbi buxhetin e planifikuar dhe të realizuar, si dhe planin dhe zbatimin e prokurimit publik në komunë. Qytetarët duhet të jenë më mirë dhe më shumë të përfshirë në procesin e planifikimit financiar, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në hartimin e politikave në nivel lokal.

Në fokus grupet u konstatua se qytetarët nuk janë në gjendje ti kuptojnë raportet financiare të komunave të përgatitura sipas standardeve të kontabilitetit, si dhe duhet komunat të publikojnë buxhete qytetare ku mund të përcaktohet sipas fushave si shpenzohen paratë e qytetarëve.

Qytetarët duan të dinë se ku shpenzohen paratë që komuna i arkëton nga gjrobat, apo nga shërbime të ndryshme (p.sh.. Shërbimet e parkimit). Kjo, përsëri tregon nevojën për njësitë e vetëqeverisjes lokale të publikojnë plane të kuptueshme dhe kontekstuale financiare dhe raporte.

Qytetarët besojnë se ka një mungesë transparence në planifikimin dhe zbatimin e prokurimit publik që i zbatojnë njësitë e vetëqeverisjes lokale, dhe për këtë arsye kanë nevojë në mënyrë të standardizuar dhe në kohë të publikohen të dhënat mbi prokurimin publik të planifikuar dhe kontratat e dhëna.


U theksua se qytetarët duhet të dinë se sa janë pagat e kryetarit të komunës, këshilltarëve dhe Administratës së vetëqeverisjes lokale, për shkak se bëhet fjalë për të dhëna publike.

Shumica e komuniteteve të targetuara kanë grupe të të dhënave (të dhëna në formë të strukturuar elektronike) të propozimit dhe buxhetit të miratuar të komunës dhe të llogaria përmbyllëse. Planet dhe raportet mbi prokurimin publik janë në dispozicion në formë elektronike si raporte (Word ose PDF) ndërsa shumica e komunave nuk kanë të zhvilluar buxhet civil.



PYETJA 9.

Shkalla e rëndësisë e të dhënave të theksuara më poshtë nga fusha e financave sipas qytetarëve (të renditura sipas përmbljedhjes së përgjigjeve “Shumë e rëndësishme” dhe “E rëndësishme”)



KËSHILLI

Lidhur me punën e këshillit të NJVL-ve, qytetarët vlerësojnë se të dhënat më të nevojshme për ata janë:

- Statuti i komunës
- Rendi i ditës. procesverbalet, Vendimet e Këshillit
- Lista e dokumenteve të miratuara të planifikimit
- Informacion për anëtarët e Këshillit.

Të anketuarit theksuan nevojën për të publikuar procesverbale të detajuara të mbledhjeve të këshillit, dhe jo vetëm si kanë votuar këshilltarët mbi pika të ndryshme në rendin e ditës në mbledhjet.

Pjesëmarrësit e fokus grupit gjithashtu besojnë se duhet të ketë informata të hollësishme për këshilltarët në komuna, duke përfshirë informacione për kontaktet e anëtarëve të këshillit. Puna e Këshillit duhet të jenë më transparente dhe, për këtë arsye, është e nevojshme që të ketë të dhëna të publikuara se kur do të mbahen mbledhjet, rendi i ditës së mbledhjeve, procesverbalet të detajuara të mbledhjeve me vendimet e miratuara dhe kështu me radhë.



Përveç kësaj, qytetarët besojnë se mbledhjet e Këshillit të NJVL-ve duhet të jenë publike ose të transmetohen drejtpërdrejt, sidomos në miratimin e planeve urbanistike.


Informacioni mbi punën e Këshillit, komunat i kanë në formë elektronike, por jo në një format të strukturuar.

Покрај тоа, граѓаните сметаат дека седниците на Советот на ЕЛС треба да бидат јавни, односно пренесувани во живо, а особено при носењето на урбанистичките планови.

Информациите за работата на Советот, општините ги имаат во електронска форма, но не во структуриран формат.

РУЕТЈА 11.

Shkalla e rëndësisë e të dhënave/informacioneve të theksuara më poshtë nga fusha e Këshillit (rezultate të përmbledhura me “Shumë e rëndësishme” dhe “E rëndësishme”)



SHËRBIME

Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se shumë të rëndësishme për to janë të gjitha shërbimet e ofruara nga vetëqeverisja lokale, duke përfshirë **listën e shërbimeve, formularë për aplikim për shërbimet, si dhe udhëzime të hollësishme për sigurimin e shërbimeve.**

Në këtë kontekst, pjesëmarrësit në fokus grupet gjithashtu mendojnë se nuk kanë informacione siç janë lista e shërbimeve që komuna e siguron, informacione mbi procedurat që qytetari duhet ti kalojë për të marrë një shërbim të caktuar. Në aspekt të formularëve qytetarët mendojnë se ato duhet të përditësohen, sepse shpesh formularët që janë në dispozicion nuk janë të zbatueshme për një shërbimin specifik. Qytetarët sidomos kanë nevojë për informacion se ku t'i marrin informacionet, sepse “që nga fillimi” nuk e dinë ku duhet të shkojnë në qoftë se duhet kryer një detyrë e caktuar administrative. Në këtë kuptim, nevoja për modernizimin elektronik dhe digjitalizim të shërbimeve komunale është e domosdoshme dhe nga ana tjetër për qytetarët të cilët nuk kanë qasje ose nuk janë në gjendje të përdorin internetin,



patjetër të sigurohen informacione përmes mediave tradicionale, buletini i komunës, lëshim të njoftimeve ose vendosjen e shtandeve për komunikim më të shpeshtë dhe më të hapur me qytetarët. Qytetarët mendojnë se kanë nevojë për një realizim më të standardizuar dhe të përmirësuar të shërbimeve nga ana e stafit në sportele.

Disa komuna i posedojnë të dhënat për shërbimet që ato i sigurojnë në një format të strukturuar elektronik, por shumica janë në formë të pastrukturuar.

ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Lidhur me fushën e zhvillimit ekonomik lokal, me prioritet më të rëndësishëm të anketuarit i kanë vlerësuar informacionet për listën e aktiviteteve tregtare në përmasë të vogël në territorin e komunës, zonat industriale në territorin e komunës dhe lista e aktiviteteve hotelierike në përmasë të vogël.


Pjesëmarrësit në fokus grupet, megjithatë, thonë se nuk janë të njoftuar dhe të informuar për planet dhe strategjitë e zhvillimit të komunës. Mungojnë informacione nga listat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që janë në zonën e tyre lokale, ekzistenca e një zone industriale.

Përveç strukturës së forcës së punës në komunë, janë të nevojshme informacione për vendet e lira të punës dhe kompanitë aktive. Qytetarët gjithashtu janë të interesuar për mundësitë e fillimit të një biznesi në komunë.

Sipas të dhënave të marra nga komunat të dhënat e identifikuar më të rëndësishme në këtë fushë, shumica e komunave nuk i kanë në mënyrë elektronike, ose as që i mbledhin.

PYETJA 15.

Të dhëna/informacione nga fusha e Zhvillimit ekonomik lokal- të renditura sipas rëndësisë për qytetarët (Sipas vlerës mesatare të fituar nga 1-6, ku 1 është më i rëndësishëm, ndërsa 6 është grup i të dhënave më pak i rëndësishëm)





MJEDISI JETËSOR


Rëndësi të madhe për qytetarët janë informacionet për nivelet e ndotjes në këtë komunë, cilat subjekte janë ndotësit, shkalla e prodhimit të mbeturinave si dhe kadastra e mjedisit jetësor.

Ajo korrespondon me problemin e përgjithshëm të nivelit të ndotjes në Republikën e Maqedonisë dhe nevojën që qytetarët rregullisht dhe me saktësi të informohen në lidhje me këto kushte.

Rezultatet e fokus grupeve tregojnë se qytetarët nuk marrin informacione kthyesë në lidhje me atë se çfarë punohet në nivel lokal në këtë fushë, dhe në fakt e njëjta mund të jetë rezultat i mungesës reale të zbatimit të aktiviteteve në këtë fushë. Për të dhëna më të rëndësishme ishin theksuar të dhënat e subjekteve - ndotës në komunë, si dhe sa është niveli i ndotjes në këtë komunë. Mungojnë informacione mbi cilësinë e ajrit dhe të ujit; informacione në lidhje me menaxhimin e ujërave të zeza të ndërmarrjeve që punojnë me materie kimike dhe biologjike të cilat janë të dëmshme për mjedisin; informacione për normën e mbeturinave që bëhen në nivel lokal; ndikimi i pikave të grumbullimit mbi tokën dhe ujërat nëntokësore. Në këtë kontekst, theksohet nevoja e marrjes së të dhënave për punën e inspektimeve të mjedisit jetësor.

Të dhënat nga mjedisor jetësor janë të mbledhura më së paku nga komunat. Në të vërtetë, gjatë anketës dhe fokus grupeve, si të dhëna më të rëndësishme janë identifikuar të dhënat për ndotësit dhe substancat e ndotësve, por pothuajse të gjitha komunat nuk i kanë aspak këto të dhëna në çfarë do forme.

17. Të dhëna/informacione nga fusha e Mjedisit jetësor të renditura sipas vlerësimit mesatar nga 1-8, ku 1 është më i rëndësishëm, ndërsa 8 është grup i të dhënave më pak i rëndësishëm





VEPRIMTARI KOMUNALE


Në fushën e veprimtarisë komunale, të anketuarit konsiderojnë se duhet të publikohen të dhëna për deponitë në territorin e komunës, tregjet në territorin e komunës, si dhe transportuesit dhe automjetet e regjistruara për transportin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacion.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve besojnë se mungojnë informacione për deponitë ekzistuese në rajonin e komunave; raportet mbi inspektimet e kryera; informacion mbi atë se çfarë shërbimesh ofron ndërmarrja komunale dhe çmimet e shërbimeve; të dhënat mbi gjendjen financiare të ndërmarrjeve publike dhe kështu me radhë.

Informacioni mbi deponitë dhe tregjet në komunë ruhen kryesisht në letër, por jo edhe në mënyrë elektronike. E njëjta gjë vlen edhe për transportuesit dhe automjetet e regjistruara për transportin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacion edhe pse një nga komunat i ruan këto të dhëna në një bazë të dhënash elektronike. Raportet e inspektimeve të kryera kryesisht janë në letër.

PYETJA 19.

Të dhëna/informacione nga fusha e Veprimtari komunale - të renditura sipas vlerës mesatare të dhënë nga 1-5, ku 1 është më i rëndësishëm, ndërsa 5 është grup i të dhënave më pak i rëndësishëm)





KULTURË

Në pyetjen për informacione të nevojshëm në fushën e kulturës, të anketuarit i renditën grupet e të dhënave në një shkallë nga 1 në 4, ku 1 është me rëndësi më të madhe.

Sipas rezultateve, për qytetarët me rëndësi më të madhe janë informacionet për objektet ekzistuese në fushën e kulturës në komunë (lokale, kombëtare) me një vlerë mesatare (2.08). Informacionet tjera janë më pak të rëndësishme për qytetarët, të tilla si të dhënat e muzeve dhe dokumentacioni, monumentet dhe pllakat përkujtimore në komunë dhe Programi për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe individëve me pllaka përkujtimore.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve vlerësojnë se ka informacione që duhet domosdo të jenë në dispozicion për qytetarët si në vijim: Njoftimi në kohë i ngjarjeve kulturore; harta e vendeve kulturore, monumentet, objektet, informacione mbi implementimin e restaurimit të objekteve kulturore; çmimet për vizitën dhe dhënia me qira e përmendoreve dhe objekteve; raportimi i përgjithshëm mbi punën e sektorit të kulturës në nivel lokal.

Tre nga shtatë komuna të analizuar janë përgjigjur se i kanë në format të strukturuar elektronik të dhënat e identifikuar në analizë, apo se rezultat më të madh ka për të dhënat e përmendoreve dhe pllaka përkujtimore, si dhe objektet e kulturës në komunë.

ARSIMI

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se janë të nevojshme informacione për numrin e shkollave fillore dhe të mesme në komunë, numri i vendeve të lira në shkolla dhe kriteret e pranimit; numri i nxënësve nëpër vendbanime, fakultete në komunë; informacione të përditësuara për zhvillimet në shkolla dhe çfarë është planifikuar në çështjen e infrastrukturës, pajisjeve, enterieri i shkollave; transparencë në shpalljen e tenderëve në kuadër të aktiviteteve shkollore (ekskursione, transporti, të ushqyerit, fotografimi); tabela e renditjes së shkollave sipas suksesit në nivel të qytetit; njoftime për sukseset e nxënësve dhe studentëve. Janë të nevojshme të dhëna për numrin e kuadrit arsimor në shkolla, sukcesi i shkollave shkaku i krahasimit të suksesit në mes të shkollave, shkollat dhe programet në dispozicion për nxënësit me nevoja të veçanta.

Dy nga shtatë komuna ruajnë të dhënat në format elektronik të strukturuar për shkollat fillore dhe të mesme në komunë, ndërsa shumica i kanë vetëm në formë të letrës.



MBROJTJA SOCIALE

Nga fusha e mbrojtjes sociale të rëndësishme janë të dhënat për numrin e përfituesve të ndihmës sociale, Institucionet për mbrojtjen sociale të kategorive të ndryshme të qytetarëve; informacion në lidhje me kategoritë e veçanta të rasteve sociale - të pastrehët dhe lypësit; mjetet që vetëqeverisja lokale i shpenzon për ndihmë sociale.

Aspekte interesante që i theksojnë të anketuarit në këtë fushë janë të dhënat për strukturën arsimore të përdoruesve të ndihmës sociale, kushtet/kriteret për marrjen e ndihmës sociale, informacioni mbi mundësitë e punësimit të qytetarëve nga kategoritë e rrezikuara sociale dhe kështu me radhë.

Dy nga shtatë komunat kanë grupe të të dhënave për numrin e përfituesve të ndihmës sociale dhe institucioneve të mbrojtjes sociale të kategorive të ndryshme të qytetarëve.

SPORT

93% e të anketuarve besojnë se të dhënat për objektet sportive në territorin e komunës janë të rëndësishme.

Përveç kësaj, pjesëmarrësit në fokus grupet vlerësojnë se janë të nevojshme informata për shumë lloj ngjarje sportive në komunë; si shpërndahen dhe shpenzohen fondet e komunës për ngjarjet sportive; funksionimi i klubeve sportive; kushtet për dhënien me koncesion të objekteve sportive; pronarët e objekteve sportive, aktivitete sportive në kuadër të shkollave, programet për zhvillimin e sportit në komunë etj.

Shumica e komunave kanë të dhëna për objektet sportive në komunën në format të pastrukturuar elektronik apo në formë letre.

URBANIZËM

Në pyetjen për informacione të nevojshëm në fushën e kulturës, të anketuarit i renditën grupet e të dhënave në një shkallë nga 1 në 9, ku 1 është me rëndësi më të madhe. Sipas rezultateve, për qytetarët më me rëndësi janë informacionet në lidhje me propozim planet urbane në territorin e komunës (PGJU dhe PDU) dhe plane të miratuara urbanistike në territorin e komunës. Përveç kësaj, si të rëndësishme i marrin të dhënat për raportet vjetore për lejet e ndërtimit, si dhe për ndërtesa të banimit dhe menaxherët.




Fokus grupet treguan se kërkohet qasje më e madhe e qytetarëve në të dhënat në lidhje me PDU dhe PGJU, si dhe te vetë dokumentet, si ato të mund të jenë në dispozicion në mënyrë elektronike; trajnim i stafit administrativ për leximin e planeve urbanistike dhe të jenë të hapur për të informuar në mënyrë adekuate dhe ti udhëzojnë qytetarët në procedurat për marrjen e shërbimeve të ofruara; çdo ndryshim i planeve dhe përditësimi i tyre të publikohet në kohë, ajo që është publikuar të jetë e kuptueshme për qytetarët e zakonshëm; të ekzistojnë të dhëna për legalizimin e objekteve që do të legalizohen dhe që tashmë janë të legalizuara; njoftime për leje të dhëna për ndërtime me shpjegime të qarta; specifikime buxhetore për kryerjen e punëve ndërtimore; të ekzistojë një listë e hapësirës në dispozicion për parkim dhe shërbime të atij lloji; informacione në lidhje me rrugët dhe vendet; rrugët emrat e të cilëve janë ndryshuar ose do të ndryshohen.

Tre nga shtatë komunat kanë plane urbane vetëm në letër, ndërsa tre komuna i kanë në formë të strukturuar elektronike. Vetëm tri komuna i mbajnë çfarë do të dhënash elektronike për lejet e lëshuara për ndërtim, dhe pothuajse të gjitha komunat (6 nga 7) nuk kanë aspak të dhëna për ndërtesat e banimit dhe menaxherët.

PYETJA 29.

Të dhëna/informacione nga fusha e Urbanizmit të renditura sipas vlerësimit mesatar të dhënë nga 1-2, ku 1 është më i rëndësishëm, ndërsa 2 është grup i të dhënave më pak i rëndësishëm





KOPSHTE PËR FËMIJË DHE SHTËPI PËR PLEQ

Të dhënat mbi kopshtet e fëmijëve në komunë (publike dhe private), janë më të rëndësishme për të anketuarit, të ndjekur nga të dhënat për ndërmarrjet publike të themeluara nga komuna të cilat kanë qasje për personat me aftësi të kufizuara dhe për shtëpi pleqsh.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve besojnë se mungon informacioni për numrin e kopshteve, vendndodhjen e tyre, kapacitetet; kushtet për përdorimin e shërbimeve të tyre, numri i të punësuarve; mos/ekzistimi i personelit mjekësor, profili i të punësuarve dhe kontaktet e tyre; mënyra e sigurimit të ushqimit, informacion për furnizuesit e ushqimit, meny ditore, çmimet.

Dy komunat kanë grupe të të dhënave për kopshtet e fëmijëve, ndërsa një komunë për shtëpi pleqsh.



REKOMANDIME

- Informimi i barabartë, i parashikueshëm dhe i rregullt i qytetarëve, duke siguruar informacione dhe të dhëna me interes për qytetarët, të sigurohet me përkufizimin e standardeve për transparencë në nivel lokal, të cilat do dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, si akt nënligjor, për çfarë është e domosdoshme të ndryshohet Ligji ose si dokument (Kod/Protokol) që si një detyrim për të gjitha komunat do të përfshihet në Statutin e komunave. Akti nënligjor ose Kodi/Protokolli duhet të përfshijë një listë të informacioneve/të të dhënave (grupe të informacioneve/të të dhënave), që domosdo duhet të publikohen në faqen e internetit të komunës, si dhe mënyra e publikimit të tyre (vendi, formati dhe dinamika e botimit dhe përditësimi).
- Në Statutin e komunave të sigurohet se opinioni për punën e komunës dhe ofrimin e shërbimeve do të informohet përmes faqes së internetit të komunës, dhe mënyrat tjera do të përdoren si një alternativë.
- Të riorganizohen përmbajtjet e ueb lokacioneve që të sigurohet qasje e lehtë për llojet e ndryshme të përdoruesve duke ndjekur si objektiv rregullin me 3 klikime, që tregon se çdo informacion në internet, përdoruesi duhet ta gjejë duke bërë maksimum tre klikime. Faqet fillestare të internetit duhet të thjeshtohen për të rritur vizibilitetin dhe efikasitetin në gjetjen e informacionit që përdoruesit e kërkojnë. Faqet e internetit duhet të ri-përpunohen për qytetarët me aftësi të kufizuara, për tu lejuar qasje të papenguar.
- Të krijohen dhe vihen në funksion mjete për komunikim interaktiv të qytetarëve dhe pushteti lokal, si një mundësi për të raportuar probleme, por edhe si një mundësi për të shprehur mendime dhe propozime, denoncime për korrupsion, alarmim ndaj nevojave të grupeve të caktuara.
- Të zhvillohen procedura për konsultim që do të publikohen në faqen e internetit, si dhe e-mjete të detyrueshme për konsultim në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) me çka do të sigurohen kushtet për efikasitet dhe gjithë përfshirje në procesin e konsultimit.
- Të sigurohen informacione të dukshme dhe uniforme të shërbimeve që i siguron NJVL-ja, të thjeshta dhe të standardizuara që t'i përdorin qytetarët (listën e shërbimeve, katalog të shërbimeve, formularë), si dhe mundësi e monitorim elektronik të statutit dhe komunikimit elektronik me administratën lokale në lidhje me çështjen.
- Të merren në konsideratë rekomandimet e dokumenteve të Këshillit të Evropës në përdorimin e teknologjive të reja dhe mjeteve të reja inovative në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies si dhe konsultimi në nivel lokal.
- Të informohen NJVL-të për obligimin që rrjedh nga Ligji për përdorimin e të dhënave të sektorit publik në lidhje me publikimin në formatin e hapur të të dhënave që ata i krijojnë. Të organizojnë trajnime për administratën e NJVL-së për konceptin e të dhënave të hapura dhe aktivitetet që duhet ndërmerren për të publikuar të dhëna të hapura.



- Standardizimi i grupeve të të dhënave (për sa i përket formatit të strukturës së të dhënave dhe semantikës së të dhënave) është e rëndësishme për politikën e të dhënave të hapura në NJVL, sepse në këtë mënyrë do të mundësohet harmonizimi i grupeve të të dhënave nga komuna të ndryshme. Nëse komunat publikojnë të dhëna të hapura me të njëjtën strukturë, me formatin e përcaktuar, përdoruesit do ta gjejnë shumë më lehtë ti kombinojnë dhe ti përdorin të dhënat nga të gjitha komunat.
- Publikimi në një format të hapur i të dhënave që tashmë i krijojnë NJVL-të në përputhje me legjislacionin përkatës, në veçanti të dhënat që janë të rëndësishme për sigurimin e llogaridhënies në punë. Varësisht nga mundësitë, është e dobishme të sigurohet vizualizimi i të dhënave të hapura (grafika, grafika rrethore) me qëllim që të sigurohet një mënyrë e lehtë dhe e shpejtë e pranimit të informacioneve, si dhe krahasueshmëria e saj.
- Prioritet të vendoset në publikimin e sa më shumë informacioneve dhe grupeve të të dhënave që janë në interes për qytetarët/shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit që do të përfitonin nga këto të dhëna.
- T'i kushtohet vëmendje të veçantë informacioneve/të dhënave që janë prioritet për qytetarët dhe në këtë drejtim NJVL ti intensifikojë aktivitetet e tyre për krijimin ose mbledhjen e atyre të dhënave dhe digjitalizimi i tyre me qëllim që të publikohen në një format të hapur.



LITERATURA E PËRDORUR

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare” nr. 52/91)
- Ligji për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare” nr. 5 /01)
- Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 13/2006, nr. 86/08, nr. 06/10, nr. 42/14, nr. 148/15)
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Gazeta Zyrtare” nr. 7/05, nr. 103/08, nr. 124/10, nr. 135/11, nr. 43/14, nr. 153/15; nr. 99/16)
- Ligji për përdorimin e të dhënave nga sektori publik (“Gazeta Zyrtare” nr. 27/14)
- Program për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2015-2020 /
- Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale
- Strategjia për inovacione dhe qeverisje të mirë në nivel lokal
- Ligji mbi Tatimin në Pronë (“Gazeta Zyrtare” nr. 61/04, nr. 92/07, nr. 102/08, nr. 35/11, nr. 53/11, nr. 84/12, nr. 188/13, nr. 154/15, nr.23/16)
- Ligji për Shërbimet turistike (“Gazeta zyrtare” nr. 62/04, nr. 89/08, nr. 12/09, nr. 17/11, nr. 47/11, nr. 53/11, nr. 123 / 12;. nr. 164/13, nr. 27/14 nr. 116/15, nr.192/15)
- Ligji për veprimtari hotelierike (“Gazeta Zyrtare” nr. 62/04, nr. 89/08, nr. 115/10, nr. 53/11, nr. 141/12, nr. 164/13, nr. 187 / 13; nr. 166/14, nr. 199/14, nr. 129/15, nr. 129/15, nr. 39/16, nr.71/16)
- Ligji për zona industriale të gjelbra (“Gazeta zyrtare” nr. 119/13, nr. 160/14, nr. 173/15, nr.192/15)
- Ligji për Mjedisin jetësor (“Gazeta zyrtare” nr.53/05)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma në mjedis jetësor (“Gazeta Zyrtare” nr. 79/07, nr. 124/10, nr. 47/11, nr. 163/13, nr.146/15)
- Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave (“Gazeta Zyrtare” nr. 68/04, nr. 107/07, nr. 102/08, nr. 124/10, nr. 51/11, nr. 123/12, nr. 147/13, nr. 163/13, nr. 51/15, nr. 146/15, nr. 156/15, nr. 192/15, nr. 39/16, nr.63/16)
- Ligji për përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore (“Gazeta zyrtare” nr. 66/04, nr. 55/07, nr. 145/10, nr. 136/11, nr. 163 / 13, nr.147/15)
- Ligji për Memorialet dhe Monumentet (“Gazeta zyrtare” nr. 66/04, nr. 89/08, nr.152/15)
- Ligji për Muzetë (“Gazeta zyrtare” nr. 66/04, nr. 89/08, nr. 116/10, nr. 51/11, nr. 88/15, nr. 152/15, nr. 39/16)
- Ligji për bibliotekat (“Gazeta zyrtare” nr. 66/04, nr. 89/08, nr. 116/10, nr. 51/11, nr. 88/15, nr. 152/15, nr. 39/16)



- Ligji për arsim fillor (“Gazeta zyrtare” nr. 103/08, nr. 33/10, nr. 116/10, nr. 156/10, nr. 6/12, nr. 18/11, nr. 51 / 11; nr. 100/12, nr. 24/13 nr. 41/14, nr. 116/14 nr. 135/14, nr. 10/15 nr.98/15, nr.145/15 nr.30/16)
- Ligji për arsim të mesëm (“Gazeta Zyrtare” nr. 52/02, nr. 40/03, nr. 42/03, nr. 67/04, nr. 55/05, nr. 113/05, nr. 35 / 06, nr.30/07, nr.49/07 nr. 81/08, nr. 92/08 nr. 33/10, nr. 116/10 nr. 156/10, nr. 18/11 nr. 51/11, nr. 6/12, nr. 100/12 nr. 24/13, nr. 41/14 nr.135/14, nr.10/15 nr.98/15; nr.145/15, nr.30/16)
- Ligji për Sport (“Gazeta zyrtare” nr. 29/02, nr. 66/04, nr. 81/08, nr. 18/11, nr. 51/11, nr. 148/13, nr. 187 / 13, nr. 42/14, nr. 138/14, nr. 177/14, nr. 72/15, nr. 153/15, nr. 06/16, nr. 61/16,106/16)
- Ligji mbi Planifikimin Urban (“Gazeta zyrtare” nr. 199/14, nr. 42/14, nr. 44/15, nr. 193/15, nr.31/16)
- Ligji për strehim (“Gazeta zyrtare” nr. 99/09, nr. 57/10, nr. 36/11, nr. 51/11, nr. 13/12, nr. 55/13, nr. 163 / 13, nr. 42/14, nr. 199/14, nr. 146/15, nr. 31/16)
- Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare” nr. 23/13, nr. 12/14, nr. 44/14, nr. 144/14, nr. 10/15, nr. 25/15, nr. 150/15, nr. 192/15, nr.27/16)
- <http://skopje.gov.mk/>
- <http://veles.gov.mk/>
- <http://stip.gov.mk/>
- <http://strumica.gov.mk/>
- <http://bitola.gov.mk/>
- <http://tetovo.gov.mk/>
- <http://kumanovo.gov.mk/>
- <http://struga.gov.mk/>
- <http://opendata.gov.mk/>
- Local Government Transparency Code 2015, Department for Communities and Local Government, February 2015
- <http://app.wheredoesmymoneygo.org/>
- <http://blindsquare.com/>



PËR AUTORËT:

Neda Maleska Saçmaroska është drejtor ekzekutiv i Qendrës për Administrim me Ndryshime, think thank organizatë e cila punon në fushën e dialogut politik, monitorimit dhe vlerësimit të politikave publike, përmirësimin e kapaciteteve institucionale të subjekteve të ndryshme dhe investimin në njerëz si agjentë kryesorë të ndryshimeve pozitive. Maleski është psikolog i diplomuar, ka një diplomë master në fushën e politikës sociale dhe është duke përgatitur tezën e doktoraturës në fushën e politikave publike dhe menaxhmentit.

Memet Memeti është profesor i administrimit publik dhe politikave publike në Evropën Juglindore (EJL). Ai ka diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë „Justinian Prvi“ pranë Universitetit Shën „Kirili dhe Metodi“- Shkup, ndërsa ka magjistruar në Universitetin i Indianës, politika publike, dhe ka doktoruar në Evropën Juglindore (EJL). Ai është autor i disa publikimeve ndërkombëtare në fushën e politikës dhe administratës publike.

Martin Todevski ka diplomuar në Departamentin e e-Biznesit në Fakultetin Ekonomik në Shkup, ndërsa ka magjistruar departamentin për Menaxhment të proekteve në Fakultetin e Elektronikës dhe Teknologjive e informatike në Shkup. Ai ka përvojë disavjeçare në fushën e reformave të administratës publike dhe e-qeverisjes, është autor i disa punimeve shkencore që lidhen me këto fusha, të cilat janë botuar në publikime dhe konferenca ndërkombëtare.

Daniela Andreska punon më shumë se 15 vjet në sektorin civil (në organizata ndërkombëtare dhe lokale) të programeve komplekse për zhvillim lokal dhe rajonal. Ajo ka përvojë të madhe në të gjithë sektorët e programit, në aspektin e zhvillimit rural / rajonal ekonomik; Proceset e decentralizacionit; Mbrojtja e mjedisit; Diversiteti i prodhimit bujqësor dhe Barazinë gjinore.

